# AKT-THEMELIMI
## (Kontrate)
## I SHOQERISE "INTER DISTRIBUTION SERVICES" sh.p.k

Sot me date 21. 03. 2007 ne mbeshtetje te ligjeve ne fuqi te Shqiperise, personat e meposhtem:

Grigor JOTI, qytetar shqiptar, lindur ne Korce me 13.02.1956, banues ne Tirane, Rr. Hafiz Ibrahim Dalliu, Nr. 62, me numer pasaporte 0011914,

Roland JOTI, qytetar shqiptar, lindur ne Korce, me 26.08.1961, banues ne Tirane, Rr. Myslym Shyri, Kulla 2/13, me numer pasaporte 0347804,

Plarent KRISTO, qytetar shqiptar, lindur ne Tirane me 29.05.1968, banues ne Tirane, Rr. Irfan Tomini, P8/3, shk.2, Ap.23, me numer pasaporte 0207968,

ortake te shoqerise "**INTER DISTRIBUTION SERVICES**" sh.p.k, rane dakort dhe kontraktuan per sa me poshte vijon:

**Neni 1**
**FORMIMI**

Krijohet shoqeria: "**INTER DISTRIBUTION SERVICES**" sh.p.k (me poshte do te referohet Shoqeria).
Shoqeria e krijuar do te veproje sipas ligjeve ne fuqi, ketij Akt-Themelimi dhe Statutit te Shoqerise.

**Neni 2**
**SELIA**

Selia e shoqerise eshte në ne adresen: Autostrada Tirane – Durres, Kilometri 1, Tirane.

**Neni 3**
**KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte e pacaktuar.

**Neni 4**
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte per sa vijon:

1. Importim, eksportim dhe tregtim me shumice dhe pakice te produkteve dhe artikujve te ndryshem ushqimore, cigareve, pijeve, te higjenes personale, kozmetike e te tualetit, detergjenteve, ushqimeve te kafsheve dhe aksesoreve te tyre, artikujve te ndryshem shtepiake, artikujve te letres dhe mjeteve te shkrimit, insekticide, artikujve kimike, pajisjeve elektroshtepiake, materiale industriale, ndertimi, te veshjeve, artikuj shkollore dhe kancelerike etj.
2. Importim, eksportim dhe tregtim i instrumentave mjeksore dhe aparaturave mjeksore.
3. Veprimtari dhe sherbime te ndryshme publiciteti, reklamimi, promocioni, kerkime tregu, transport mallrash, konsulence, asistence juridike, operacione te ndryshme komisionere.

dhe pergjithesisht cdo operacion financiar tregtar, sherbimi, industrial, me pasuri te luajtshme ose te paluajtshme qe mund te lidhen drejtperdrejt ose terthorazi me nje nga objektet e siperpermendura.

**Neni 5**

**KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Pjeset e kapitalit jane nenshkruar dhe jane shlyer teresisht nga:

| | |
|---|---|
| Z. Grigor Joti | 1/3 pjese te kapitalit |
| Z. Roland Joti | 1/3 pjese te kapitalit |
| Z. Plarent Kristo | 1/3 pjese te kapitalit |

**Neni 6**

Ndarja e fitimit dhe humbjeve te shoqerise midis ortakeve do te jete ne raportet e pjesemarrjes se tyre ne kapitalin e Shoqerise pra :

| | |
|---|---|
| Z. Grigor Joti | 1/3 pjese te kapitalit |
| Z. Roland Joti | 1/3 pjese te kapitalit |
| Z. Plarent Kristo | 1/3 pjese te kapitalit |

**Neni 7**

**ORGANET DREJTUESE**

Organet kryesore te shoqerise do te jene:

1. Asambleja e Pergjithshme Ortakeve.
2. Administratori

Perberja e tyre, kompetencat, menyra e organizimit etj, do te percaktohen ne Statutin e shoqerise te miratuar nga ortaket.

**Neni 8**

Per sa nuk percaktohet ne kete Akt Themelim, i referohet legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

**Neni 9**

Ky Akt Themelimi hyn ne fuqi pas firmosjes se tij nga ortaket.

**Grigor JOTI**

**Roland Joti**

**Plarent Kristo**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**Nr.1327 Rep.**
**Nr.603/3 Kol**




Sot me date 22 .03.2007 (dymijeeshtate) para meje noterit Dusho Dusha ne zyren e ndodhur ne rrugen Reshit Collaku, pallatet e shallvareve nr.41, u paraqiten personalisht:

1. Z. Grigor Joti, shtetas shqiptar, lindur me 13.02.1956, ne Korçe dhe banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes nr.EV 081674

2. Z. Roland JOTI i biri i Spiros dhe i Poliksenit, lindur ne Korçe me 26.08.1961, dhe banues ne Tirane Rr: Myslym Shyri, Kulla 2/131 mbajtes i pasaportes 1762199,

3. Z. Plarent Kristo i biri Sazanit dhe Zhanetes, lindur ne Tirane me 29.05.1968, dhe banues ne Tirane Rr: Irfan Tomini, P8/3, Shk.2, Ap.23 me pasaporte nr. Z 0186656.

Madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar per identifikimin e te cilive u sigurova nga leternjoftimet personale, me deklaruan se akti i mesiperm eshte sipas vullnetit te tyre te lire dhe ne baze te ligjes nenshkruan para meje noterit.
Une noteri e vertetoj ate konform ligjit.

**N O T E R**

**DUSHO DUSHA**

*NOTER*
*DUSHO DUSHA*

# STATUTI I SHOQERISE
# "INTER DISTRIBUTION SERVICES"

**Neni 1**
**Forma e shoqerise**

Shoqeria do te jete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Shnderimi i saj ne nje forme tjeter do te behet sipas dispozitave te ketij Statuti dhe Ligjit nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

**Neni 2**
**Objekti i veprimtarise se shoqerise**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte per sa vijon:

1. Importim, eksportim dhe tregtim me shumice dhe pakice te produkteve dhe artikujve te ndryshem ushqimore, cigareve, pijeve, te higjenes personale, kozmetike e te tualetit, detergjenteve, ushqimeve te kafsheve dhe aksesoreve te tyre, artikujve te ndryshem shtepiake, artikujve te letres dhe mjeteve te shkrimit, insekticide, artikujve kimike, pajisjeve elektroshtepiake, materiale industriale, ndertimi, te veshjeve, artikuj shkollore dhe kancelerike etj.
2. Importim, eksportim dhe tregtim i instrumentave mjeksore dhe aparaturave mjeksore.
3. Veprimtari dhe sherbime te ndryshme publiciteti, reklamimi, promocioni, kerkime tregu, transport mallrash, konsulence, asistence juridike, operacione te ndryshme komisionere.

dhe pergjithesisht cdo operacion financiar tregtar, sherbimi, industrial, me pasuri te luajtshme ose te paluajtshme qe mund te lidhen drejtperdrejt ose terthorazi me nje nga objektet e siperpermendura.

**Neni 3**
**Emertimi i shoqerise**

Emertimi i plote i shoqerise eshte: "INTER DISTRIBUTION SERVICES" sh.p.k.
Ne te gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqeria, emertimi i shoqerise do te ndiqet menjehere nga fjalet "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar", ose inicialet sh.p.k duke treguar edhe shumen e kapitalit themeltar. Keto shenime dhe emri i administratorit duhet te figurojne ne te gjitha aktet ose dokumentat e shpallura nga shoqeria, te destinuara per te tretet.

**Neni 4**
**Selia e shoqërisë**

Selia e shoqerise eshte në ne adresen: Autostrada Tirane – Durres, Kilometri 1, Tirane.

Selia e shoqerise mund te transferohet kudo ne territorin e Shqiperise ne baze te nje vendimi te Asamblese se Ortakeve.
Shoqëria mund te krijoje filiale, agjensi, zyra perfaqesimi brenda vendit, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, po ashtu edhe jashte vendit ne perputhje me legjislacionin e atij vendi pa cenuar legjislacionin shqiptar.

**Neni 5**
**Kohezgjatja e shoqerise**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise, do te jete pa afat te caktuar.
Ndryshimi i afatit, ose prishja e shoqerise, behet me vendim te Asamblese se Ortakeve, sipas parashikimeve ne fuqi per kete qellim.

**Neni 6**
**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Pjeset e kapitalit jane nenshkruar dhe jane shlyer teresisht nga:

| | |
|---|---|
| Z. Grigor Joti | 1/3 pjese te kapitalit |
| Z. Roland Joti | 1/3 pjese te kapitalit |
| Z. Plarent Kristo | 1/3 pjese te kapitalit |

Ndarja e fitimit dhe humbjeve te shoqerise midis ortakeve do te jete ne raportet e pjesemarrjes se tyre ne kapitalin e Shoqerise pra :

| | |
|---|---|
| Z. Grigor Joti | 1/3 pjese te kapitalit |
| Z. Roland Joti | 1/3 pjese te kapitalit |
| Z. Plarent Kristo | 1/3 pjese te kapitalit |

**Neni 7**
**Ndryshimet e kapitalit themeltar**

Kapitali themeltar, mund te ndryshohet me te gjitha menyrat dhe modalitetet e kerkuara nga legjislacioni ne fuqi per kete qellim. I vetmi organ kompetent, per te vendosur ndryshimin e kapitalit themeltar, eshte Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, e cila merr vendime ne baze te raportit te Administratorit qe permban treguesit e kerkuar nga ligji.

**Neni 8**
**Ortaket e shoqerise**

Ortaket e shoqerise mund te jene persona fizik dhe/ose juridike, qe kane vene ose do te vene ne zoterim pjese te kapitalit te shoqerise, me te gjitha menyrat e parashikuara nga ligji.
Pronesia mbi pjeset e kapitalit te shoqerise, permban aderimin me te drejta te plota ne statutin e shoqerise nepermjet perfaqesimit ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve.

**Neni 9**
**Te drejtat dhe detyrat e ortakeve**

Cdo ortak, ka te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shpemdashme te shoqerise dhe perfiton propocionalisht me pjesemarrjen e tij ne kapitalin e shoqerise.
Cdo ortak, ka te drejten te marre, kur eshte rasti, nje pjese nga teprica e likujdimit te shoqerise ne te njejtin perpjestim sipas paragrafit te pare te ketij neni.
Ortaket kane te drejten e votes ne perpjestim me pjeset e tyre te kapitalit ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi dhe ky statut.
Ortaket jane vete pergjegjes per detyrimet dhe per humbjet e shoqerise deri ne kufirin e pjeseve te kapitalit qe zoterojne.

**Neni 10**
**Shitja dhe transferimi i pjeseve te kapitalit**

Kur nje nga ortaket kerkon te shese pjeset e tij te kapitalit, ne rradhe te pare ai duhet t'ia ofroje ato ortakeve te tjere te shoqerise dhe vetem kur keta te fundit heqin dore, pjeset e kapitalit mund t'u shiten personave te trete me miratimin e shumices prej 3/4 te ortakeve te shoqerise. Per kete arsye, shoqerise i dorezohet nje kerkese miratimi ku tregohen emri, mbiemri dhe adresa e personit qe i transferohet pronesia, numri i pjeseve te kapitalit qe parashikohen te transferohen dhe cmimi i ofruar. Miratimi konsiderohet i dhene nepermjet nje njoftimi ose kur nuk eshte dhene pergjigje brenda nje afati 3-mujor nga data e kerkeses.
Transferimi i pjeseve te kapitalit duhet te behet me akt noterial, perndryshe transferimi eshte i pavlefshem.
Ne rastin e zmadhimit te kapitalit, pjeset e kapitalit jane te tregtueshme, pas regjistrimit te ketij ndryshimi.

**Neni 11**
**Organet drejtuese te shoqerise**

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. Asambleja e Pergjithshme Ortakeve,
2. Administratori

**Neni 12**
**Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve perbehet nga te gjithe ortaket e shoqerise.
Mbledhjet e Asamblese mund te jene te zakonshme ose te jashtezakonshme. Mbledhja e zakonshme zhvillohet 2 here ne vit. Pervec mbledhjeve te zakonshme mund te therriten mbledhje te jashtezakonshme te Asamblese se Pergjithshme kur kete e kerkon me teper se ½ e anetareve te saj.
Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, qofte e zakonshme ose e jashtezakonshme, ka kompetenca dhe merr te gjitha vendimet e percaktuara nga ligji "Per shoqerite tregtare" ose nga statuti.
Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te mbahet ne zyren e regjistruar te shoqerise, ose ne nje vend tjeter te caktuar me pare ne lajmerimin per mbledhje.
Asambleja merr vendime te vlefshme vetem ne rast se ortaket e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten 1/2 e pjeseve te kapitalit. Ajo merr vendim me shumicen e votave te ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar. Ketu ben perjashtim rasti kur ligji kerkon nje shumice me te larte votash.

**Neni 13**
**Administratori i shoqerise**

Administratori i Shoqerise emerohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve dhe do te ushtroje funksionet e tij nen kontrollin e Asamblese.
Administratori mund te shkarkohet per shkaqe te perligjura nga Asambleja. Si shkaqe te perligjura konsiderohen vecanerisht nje faj i rende i Administratorit, paaftesia e tij ne kryerjen korrekt te funksioneve ose kur asambleja humbet besimin tek ai.

Administrator i Shoqerise eshte zgjedhur: Z. Aleksander Kqdiqi, lindur ne Tirane me 17.07.1973 dhe banues ne Tirane Rr. Vaso Pasha, P 27, Shk.4, Ap.13 me nr. Pasaporte Z0894130.

**Neni 14**
**Kompetencat dhe kufizimet**

Administratori ka kompetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise, kompetenca qe i ushtron brenda aktivitetit te veprimtarise se saj.
Administratori eshte i detyruar para shoqerise te respektoje kufizimet e percaktuara me ligj dhe nga statuti lidhur me hapesiren e autoritetit te tij menaxhues.

**Neni 15**
**Veprime qe kerkojne autorizim paraprak**

Administratori i shoqerise nuk mund te kryeje pa miratimin e Asamblese se Ortakeve vendosjen si garanci per detyrimet e ndryshme, pasurine e paluajtshme te shoqerise.

**Neni 15**
**Perfaqesimi**

Nga ana ligjore, shoqeria perfaqesohet ne te tretet nga Administratori i saj.

**Neni 16**
**Ndarja, bashkimi dhe likuidimi i shoqerise.**

Shoqeria mund te shkrihet, likuidohet ose transformohet ne nje forme tjeter, perpara afatit te percaktuar, me vendim te mbledhjes se jashtezakonshme te Ortakeve, ne perputhje me parashikimet e ligjit: "Per shoqerite tregtare".

**Neni 17**
**Dispozita te pergjithshme**

Per te gjitha çeshtjet qe nuk jane percaktuar ne kete statut, do te zbatohet ligji nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

**Grigor JOTI**

**Roland JOTI**

**Plarent KRISTO**